



Prishtinë: 24.09.2018

Kodi i ZRRE-së: V_1041_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1846_08_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **13.09.2018**.

në seancën e mbajtur më datë 24.09.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin F. L. nga Fushë Kosova me shifër të konsumatorit: DPR - 90111229, si e pa bazuar.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1846_08_18 i datës 17.08.2018.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 13.09.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se korrigjimi i KESCO-s është real dhe bazohet në Pëlqimin Elektroenergjetik (PEE). Në ankesë është theksuar se krahasimi i shpenzimeve të energjisë elektrike nuk mund të merret si dëshmi pasi që konsumatori në disa periudha ka shpenzim më të lartë e në disa periudha shpenzim më të ulët. Në ankesë po ashtu është theksuar se nuk mund të merret për bazë fatura e kompanisë "Pastrimi" pasi që kjo nuk nënkupton edhe fillimin e shpenzimit të energjisë elektrike. Në ankesë po ashtu është theksuar se nëse merret parasysh krahasimi i shpenzimeve atëherë korrigjimi do të duhej të bëhet për periudhën 2 mujore, mirëpo KESCO ka bërë korrigjimin sipas PEE për periudhën 4 mujore. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_1846_08_18 i datës 17.08.2018 për konsumatorin F. L. me shifër DPR - 90111229.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 24.9.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s korrigjimi i KESCO-s është real dhe bazohet në Pëlqimin Elektroenergetik (PEE), Bordi i ZRRE-së thekson se sipas procesverbalit për pranim të instalimit elektrik nr.0085603 të datës 25.03.2016 evidentohet se sipas gjendjes së shpenzimit të njehsorit elektrik të evidentuar në procesverbal, konsumatori ka qenë i kyçur në rrjetin elektrik qysh më herët, dhe kjo vërtetohet edhe përmes gjendjes së shpenzimit të njehsorit elektrik nr.63900712 prej TL=2300 kWh dhe TU=1706 kWh.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se krahasimi i shpenzimeve të energjisë elektrike nuk mund të merret si dëshmi, Bordi i ZRRE-së thekson se edhe kjo nuk qëndron pasi që krahasimi i shpenzimeve të energjisë elektrik është indikator mjaft i rëndësishëm gjatë shqyrtimit të lëndëve të konsumatorit. Bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike konstatohet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore, përveç periudhës kontestuese. Se krahasimi i shpenzimeve të energjisë elektrike është mjaft i rëndësishëm e dëshmon edhe fakti se sipas analizave të bëra shpenzimit të energjisë elektrike vërehet se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike prej periudhës 05/2016 e deri më 07/2018 është 623.78 kWh/muaj, si dhe shpenzimi i energjisë elektrike në sezonën verore mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike prej periudhës 05/2016 e deri më 09/2016 është 239.80 kWh/muaj, si dhe prej periudhës 04/2017 e deri më 09/2017 është 264.33 kWh/muaj, ndërsa në sezonën dimërore mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike prej periudhës 10/2016 e deri më 03/2017 është 940.83 kWh/muaj, si dhe prej periudhës 10/2017 e deri më 03/2018 është 1053.17 kWh/muaj. Pra nga kjo shihet qartë se shpenzimi i ngarkuar i muajit 04/2016 nuk paraqet shpenzim real mujor nëse krahasohen me shpenzimet e konsumatorit pas kësaj periudhe, andaj edhe mund të konstatohet se fatura e muaji 04/2016 paraqet grumbullim të shpenzimit të energjisë elektrike të muajve paraprak.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se nuk mund të merret për bazë fatura e kompanisë "Pastrimi" pasi që kjo nuk nënkupton edhe fillimin e shpenzimit të energjisë elektrike, Bordi i ZRRE thekson se konsumatori ka siguruar transaksionet e kompanisë rajonale për mbeturina "Pastrimi", ku sipas transaksioneve vërehet se fatura e parë konsumatorit për mbeturina i ka arritur për muajin 12/2014, pra sipas kësaj fature vërehet qartë objekti i konsumatorit që nga ajo kohë ka qenë në shfrytëzim nga konsumatori. Bordi i ZRRE-së gjithashtu thekson se përveç argumentit të transaksioneve të kompanisë "Pastrimi" ku është marrë si bazë për shqyrtim të lëndës për shpërndarje të shpenzimit, duhet theksuar se nëse merret parasysh mesatarja e shpenzimit të konsumatorit të periudhës 05/2016 e deri më 12/2016 atëherë del se periudha e shpërndarjes përputhet me periudhën e transaksioneve të kompanisë Rajonale "Pastrimi".

Bordi i ZRRE thekson se gjatë analizës së bërë shkresave të lëndës ka vërejtur se faturimi i muajit 04/2016 paraqet grumbullim të shpenzimit të energjisë elektrike të muajve paraprak dhe nuk paraqet shpenzim real mujor, dhe se duke u bazuar në Pëlqimin Elektroenergetik nr. nr.11160 i datës 28.12.2015 dhe kërkesën për regjistrimin e njehsorëve elektrik e datës 14.03.2016, si dhe duke pasur parasysh edhe transaksionet e konsumatorit të kompanisë rajonale për mbeturina "Pastrimi" në të cilën dokument vërehet se fatura e parë për mbeturina konsumatorit i ka arritur për muajin 12/2014, si dhe shpenzimin e energjisë elektrike të periudhës pas periudhës kontestuese, atëherë konstaton se konsumatorit i është dashur t'i bëhet shpërndarja e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën 12/2014 e deri më 04/2016, e ku pas shpërndarjes së shpenzimit të energjisë elektrike rezulton se konsumatori duhet të korrigjohet në vlerë prej -63.86€

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.09.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit Fejsal Lutfiu, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.